

Dr. Ledia DUSHKU

KRYENGRITJA SHQIPTARE E VITIT 1910 DHE GREQIA

Politika e Turqve të Rinj dhe kryengritja në Kosovë

Kur Turqit e Rinj ngritën flamurin e revolucionit në korrik 1908, ata nuk patën përkrahës më të zjarrtë se sa shqiptarët. Pavarësisht se shkaqet që i shtynë këta të fundit ta përkrahnin gjallërisht Lëvizjen ishin të shumëllojshme dhe me ndryshime themelore midis tyre, shqiptarët e mirëpritën rivendosjen e Kushtetutës Osmane. Disa duke e parë si mbrojtëse të privilegjeve, të tjerë si prelud të autonomisë kulturore e politike të tyre.

Pasi morën në dorë frenat e pushtetit, Turqit e Rinj menduan të vinin në jetë parullën e përdorur gjatë Revolucionit: “Liri, barazi, vëllazëri”, e tyre. Për ta, “bashkimi osman” nuk ishte gjë tjetër veçse bashkimi i të gjitha njësive etnike të Perandorisë, duke i dhënë fund të gjitha prirjeve separatiste. Xhonturqit kërkonin kështu të centralizonin dhe të racionalizonin gjithçka në Perandori; të eliminonin një herë e mirë bashkësitë etniko-fetare gjysmë autonome, të cilat duke i quajtur anakronizëm, përfaqësonin një sfidë të vërtetë për konceptin e tyre për shtetin.

Në shtetin osman nuk duhej të kishte më turq, shqiptarë, grekë, armenë, arabë, por vetëm qytetarë osmanë të bashkuar, të barabartë përpara ligjit, me të drejta dhe detyra të njëjta¹.

Por, kombet dhe popujt e Perandorisë kishin një përfytyrim tjetër për “bashkimin osman”. Për ta, “bashkim” do të thoshte ruajtje dhe pse jo lulëzim i sistemit të autonomisë kulturore, në përputhje me të cilën, ata do të vazhdonin të ishin në radhë të parë shqiptarë, grekë apo armenë e më pas osmanë, shtetas të Perandorisë. Si shpërblim për pjesëmarrjen në luftë kundër despotizmit, elita e tyre kërkonte të kishte më tepër se një vend në punët e shtetit. Ajo kërkonte të kishte më tepër autonomi, shumë prej të cilëve nënkuptonin dhe ëndërronin pavarësinë. Pjesa tjetër e popullsisë, shihnin rastin që të vinte në jetë dëshirat për reforma, drejtësi, decentralizim, ç’ka nënkuptonte ruajtje të privilegjeve.

Vendosja e Kushtetutës jo vetëm që nuk i fashiti problemet kombëtare por i shtoi edhe më tepër ato. Pas shtypjes së puçit të prillit 1909, në të cilin “të shtypurit” luajtën një rol të dorës së parë, Turqit e Rinj vendosën të vinin në jetë pikëpamjet e tyre centralizuese, duke marrë një varg masash. Në gusht 1909, doli Ligji mbi Shoqatat, zbatimi i të cilit shpërndau shoqatave kulturore dhe mbylli klubet patriotike. Shpërbërja e çetave në territoret e njohura si Maqedoni do të bëhej nëpërmjet vënies në jetë të Ligjit mbi ndalimin e çetave në Rumeli dhe Ligjit mbi Komitet. Parashikohej kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak edhe për popullsinë jo myslimane. Ndërkaq, Ligji për Kishat i vitit 1910 shqetësoi popullsinë e krishterë, në varësi të Patrikanës së Stambollit. Po ashtu, Xhonturqit menduan të centralizonin edhe sistemin arsimor në Perandori. Fillimisht, ata u përpoqën të devijonin ecurinë e arsimit kombëtar, por pasi dështuan, vendosën ta asgjësonin krejtësisht atë. Sakaq, u krijua

¹ *Historia e Perandorisë Osmane* nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: Dituria, 2004, f. 551-552

një inspektorat për shkollat jo turke dhe u kërkua të vendosej me detyrim nëpër shkolla dhe gjykata, gjuha turke si gjuhë zyrtare.

Masat e marra shkaktuan zhgënjim e pakënaqësi sidomos tek shqiptarët, grekët e armenët. Një pjesë e tyre u zhgënjye sepse Kushtetuta nuk u sollli lirinë e shpresuar, mirëqenien materiale dhe zhvillimin e lirë kombëtar, të tjetër sepse ajo nuk u garantoi ruajtjen e traditave dhe privilegjeve të kamotshme. Por të gjithë bashkoheshin në një pikë: Regjimi i vjetër kishte qenë i keq, ndërsa i riu i padurueshëm².

Pasojat e përbashkëta të kësaj politike ishin një premisë e mirë që popujt e kombet e shtypur në Perandori të ishin bashkë për ta kundërshtuar atë. Ndërsa në Parlamentin Osman deputetët liberalë me në krye Ismail Qemalin kundërshtonin politikën e Turqve të Rinj, në mars 1910 në Kosovë shpërtheu kryengritja. Opinioni dhe politika e theksuar antishqiptare e guvernatorit të përgjithshëm të Kosovës, Masar Beu i dha fund durimit të malësorëve. Ata kundërshtuan përpjekjet e qeverisë për të vendosur taksa, për të ngritur shkolla turke, për të përdorur gjuhën turke në administratë dhe alfabetin arab për të shkruar shqipen. Ligji për ndalimin e çetave, i cili urdhëronte çarmatosjen e popullsisë civile u ndje së tepërmi prej tyre. Edhe shqiptarët katolikë ishin të pakënaqur pasi detyroheshin të shërbenin në ushtrinë e sulltanit dhe të mos kishin më venome. Sakaq ligji për kishat shqetësoi popullsinë e krishterë që varej nga Patrikana.

Greqia dhe kryengritja e vitit 1910

Për një sërë arsyesh Greqia ishte e ndjeshme ndaj zhvillimeve në viset veriore shqiptare.

Në planin e luftës antiosmane, ajo nuk e kishte anashkaluar asnjëherë faktorin shqiptar. Në rast se lëvizja e shqiptarëve nuk mbetej e lokalizuar, por hapte tiparin e një lëvizjeje të gjerë

ballkanike për më shumë të drejta të popujve dhe kombeve të Perandorisë Osmane, Mbretërisë Greke i nevojitej forca e tyre, veçanërisht e myslimanëve, të cilët shquheshin për karakterin e tyre luftarak dhe kurajoz krahasuar me popullsinë e krishterë³. Gjatë 10-vjeçarit të parë të shek. XX, Greqia vazhdoi të ishte e dobët ekonomikisht e ushtarakisht. Kryengritja e Ilindenin e vitit 1903 dhe qëndrimi që Greqia mbajti ndaj saj, jo vetëm që acaroi marrëdhëniet me Portën por nxori në skenë fuqishëm edhe rivalitetin greko-bullgar. Në këtë situatë politika greke kishte kuptuar se për sa kohë ishte e dobët dhe Fuqitë e Mëdha mbështesnin ruajtjen e *status-quo*s në Ballkan, ajo nuk duhej të shfaqej aktive në çështjet ballkanike, por të ishte e kujdesshme dhe pse jo të shfrytëzonte përpjekjet e të tjerëve.

Pas Luftës Greko-Osmane të vitit 1897 dhe deklaratës së njëanshme të Asamblesë së Kretës për bashkim me Greqinë (24 shtator 1908), çështja e Kretës apo e Gjiritit siç njihet në dokumentacionin e kohës, u bë sërish e ndjeshme në fillim të vitit 1910. Oficerët kretas i kërkuan qeverisë së tyre të zyrtarizonte aleancën me Greqinë⁴. Kjo kërkesë u kundërshtua fort prej popullsisë myslimane në ishull, ndërsa Perandoria Osmane kërcënoi me vendosjen e trupave dhe marrjen nën kontroll të situatës aty. Tërthorazi, ajo akuzoi qeverinë greke për nxitje të veprimeve në Kretë dhe filloi përgatitjet për luftë. Në kufirin osmano-grek u dërguan përforcime dhe filloi ngritja e fortifikimeve. Ndërkohë, autoriteteve lokale iu bë thirrje për të mbledhur vullnetarë dhe për të organizuar mitingje solidariteti në mbrojtje të të drejtave të nëpërkëmbura të popullsisë myslimane në Kretë.

3 Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej, AQSH), F. 1501/3, V. 1912, D.24, fl. 7-8. Raport i Konsullatës italiane në Janinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, Janinë, 3 maj 1909.

4 Anderson, Frank Maloy and Amos Shartle Hershey, *Handbook for the Diplomatic History of Europe, Asia, and Africa 1870-1914*. Prepared for the National Board for Historical Service. Washington DC: Government Printing Office, 1918.

Në këtë situatë të acaruar, Porta po përballlej edhe me kryengritjen në Kosovë. Në ato momente, fuqizimi i kryengritjes shqiptare ishte i pëlqyeshëm për Greqinë, sepse zhvendoste vëmendjen e Portës nga çështja e Kretës dhe njëkohësisht dobësonte forcën ushtarake osmane që mund të dërgohej në ishull. Ndonëse zyrtarisht, ajo orvatej të mbante një relacion konkret dhe të mirë me shtetin osman⁵, çfarëdo ndërlikimi në Ballkan i jepte shpresë asaj, në vetvete të pa zonjën për të peshkuar në ujëra të turbullta. Për sa kohë shteti grek ishte i dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht e në marrëdhënie jo të paqta me fqinjët, dhe Fuqitë e Mëdha të bindura për ruajtjen e *status-quo*s, Greqia druante të shfaqej aktive në çështjet ballkanike. Ajo përpiqej të shfrytëzonte me çdo mjet situatën e krijuar në veri, për të siguruar ndërhyrjen e Evropës, ndërhyrje kjo, që do të sillte hapjen e diskutimeve për çështjet e pazgjidhura në Perandorinë Osmane, dy ndër të cilat, ajo kretase dhe maqedonase konsideroheshin primare dhe tejet të vështira për politikën greke.

Nga ana tjetër, një sukses qoftë edhe i çalë i shqiptarëve mund të kishte konsekuenca fatale jo vetëm për regjimin e ri, por edhe për shtetin osman. Prestigji i Perandorisë mund të vihej në rrezik sepse kryengritja e Kosovës mund të shërbente si katalizator edhe në Maqedoni, territoret arabe, etj.⁶ Shtypja e plotë e kryengritjes dhe veçanërisht çarmatimi i shqiptarëve nga ushtria osmane, vlerësohej një punë e vështirë dhe e gjatë. Ato lypnin përdorimin e një ushtrie të madhe, madje mund edhe të paralizonte riorganizimin e ushtrisë osmane, gjë që mund të influenconte në aspiratat latente të popujve e shteteve ballkanike

5 *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A,PA,A), në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH) Vj. 21-3-322, Raport politik i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 1 prill 1911*

6 *Po aty, Vj. 20-14-1478, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll për ministrin e Punëve të Jashtme, Erental, Stamboll, 27 prill 1910*

⁷ Perandoria Osmane gjendej në një situatë të vështirë. Nëse ajo i zhvendoste ushtarët në krahina të tjera të shtetit për t'i përdorur në beteja të përsëritura e të rrezikshme me shqiptarët, ruajtja e status-quo ishte e kërcënuar dhe aspiratat e dremitura nacionaliste të shteteve ballkanike do të rizgjoheshin. Gjithashtu, angazhimi i forcave ushtarake osmane në veri, i jepte dorë Greqisë për të zbatuar më me lehtësi politikën e helenizimit të shqiptarëve ortodoksë në vilajetin e Janinës, popullsi kjo e pretenduar si greke nga zyrtarët grekë.

Në këtë situatë politika greke ndaj çështjes shqiptare duhej të merrte karakter të dyfishtë: paqësor dhe të armatosur. E para nënkuptonte ndërmarrjen e veprimeve politike që synonin kanalizimin e çështjes shqiptare drejt një shteti dualist shqiptaro-grek. Në funksion të këtij qëllimi pretendohej të ndihmohej edhe për emancipimin shpirtëror të shqiptarëve. E dyta nënkuptonte përkrahjen e vazhdueshme të kryengritjeve në viset veriore shqiptare kundër Perandorisë Osmane. Sipas korrespondencës së brendshme zyrtare greke, kryengritjet në veri dobësonin forcën ushtarake osmane, shtonin urrejtjen e shqiptarëve ndaj turqve duke kalitur kësisoj ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve myslimanë dhe ndiznin interesin e Evropës për Shqipërinë⁸.

Në momentin kur çështja shqiptare do të dilte nga kuadri i politikës së brendshme osmane duke marrë përmasa evropiane, ministri i Jashtëm grek, Grisparis i bënte me dije konsullatave greke në vilajetet e Rumelisë, se Greqia do të ndiqte më me interes ngjarjet në territoret shqiptare sepse asnjë zgjidhje e çështjes shqiptare nuk do të ishte e mundur pa cenuar sadopak

⁷ *Po aty*, Vj. 20-14-1480, Shkresë private e ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Erental për ambasadorin në Stamboll, Vjenë, 28 prill 1910

⁸ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις* Επιμέλεια: Βασίλειος, Κόντης, Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών. Τόμος I, 1897-1918, Αθήνα: Εστιασ, 2004, f. 237-239, Raport i Sahturisit për Venizelosin, dhjetor 1911

interesat e larta greke. Pavarësisht se në korrespondencën e mësipërme, Greqia deklarohet e interesuar për themelimin e një shteti shqiptar, i cili konsiderohet për të një “mik i sinqertë” dhe “aleat i domosdoshëm”, ajo nuk hezitonte të shprehej se “nuk do të pranonte asnjëherë zgjidhjen e çështjes shqiptare, në mënyrë të tillë, që të cenonte interesat e saj në Epir”⁹. Në funksion të kësaj politike, qeveria greke u përpoq ta mbante popullsinë ortodokse të vilajetit të Janinës sa më larg Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të intensifikonte helenizimin dhe njëkohësisht të veçonte çështjen e Epirit nga ajo shqiptare¹⁰ duke u përpjekur të ndalonte përhapjen e kryengritje shqiptare në territoret jugore.

Në riorientimin e politikës greke ndikoi edhe politika italiane. E interesuar për Ballkanin që në vitin 1876, Italia synonte depërtim paqësor në viset jugore shqiptare. Lidhjet që ekzistonin mes Romës dhe komunitetit shqiptar në Italinë e Jugut, anëtarët e të cilit kishin organizuar shoqëri që mbështesnin “autonominë” e ardhshme të Shqipërisë, sipas Vezirit Osman, vlonjatit Mehmet Ferid pasha shprehnin qartë, synimet e Italisë. Sipas një vlerësimi të përgjithshëm bërë prej tij në maj të vitit 1906, “Italia ishte e vendosur të forconte dhe të shtrinte ndikimin e saj në viset shqiptare duke synuar ta kthente detin Adriatik në një liqen italian”¹¹. Synimet dhe qëndrimet e Italisë ndaj viseve shqiptare, binin ndesh me interesat dhe punën e kahershme që Greqia bënte në atë zonë. Që në vitin 1904, nënkonsulli grek në Durrës vinte në dukje pengesat e “padurueshme” që sillte i propaganda italiane, e cila punonte hapur kundër Greqisë¹².

9 Vasilis Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në Shekullin XX*, Selanik: Paratiritis, 2007, Shtojcë dokumentesh, Raport i Ministrisë së Jashtme Greke për konsullatat e Epirit dhe të Shqipërisë, Athinë, 30 qershor 1911, f. 148

10 *Po aty*, f. 27

11 George Gaërich, *Gjysmëhëna dhe shqiponja. Sundimi otoman, islamizmi dhe shqiptarët, 1874-1913*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2007, f. 197.

12 Νικολαΐδου Ι. Ελευθερία, , Ξένες προπαγάνδες και έθνική αλβανική κίνηση στις μιτρολιτικές επαρχίες Δυρραχίου και Βελεγράδων κατά τα τέλη του

Bashkëpunimi shqiptaro-grek: bisedimet e Ismail Qemalit

Në këtë situatë Greqia intensifikoi kontaktet me elitën politike shqiptare. Jo rastësisht përfaqësuesi i saj që mbajti lidhje dhe zhvilloi bisedime me zyrtarët e lartë grekë ishte Ismail Qemali. Ai rridhte nga një familje e madhe shqiptare me një pozicion tradicionalisht të privilegjuar brenda Perandorisë Osmane¹³. Ishte i matur, i zgjuar dhe gëzonte reputacion tek popullsia myslimane edhe e krishtere në territoret jugore shqiptare. Gjithashtu, falë inteligjencës dhe aftësive të tij të rralla diplomatike, kishte arritur një pozitë të rëndësishme në Perandorinë Osmane, duke qenë ndër shqiptarët më të shquar që kishte shërbyer në administratën e lartë të saj. Kishte bërë një karrierë të suksesshme aty, duke mbajtur poste të rëndësishme që nga kryetari i Bashkisë së Janinës e deri te Guvernatori i Vilajetit të Bejrutit e Tripolit¹⁴. Aftësitë e tij intelektuale e politike kishin krijuar besimin tek popullata shqiptare, se Ismail Qemali ishte një faktor, të cilin qeveria osmane duhet ta konsideronte seriozisht. I cilësuar si antiosman por jo antiperandori¹⁵, ai prej kohësh kishte kundërshtuar politikat centralizuese të Portës duke acaruar marrëdhëniet e tij me të. Admironte në mënyrë të dukshme reformatorin radikal dhe të famshëm Mid'hat Pashën, njëkohësisht babai i Kushtetutës osmane të vitit 1876.

19οῦ καὶ ἀρχῆς τοῦ 20οῦ αἰῶνα, Ἰωάννινα: 1978 (Shfrytëzuar përkthimi në AIH, A-IV-422, Propagandat e huaja dhe LKSH në krahinën metropolitane të Durrësit dhe të Beratit në fund te shek 19 dhe fillim të shek të 20, Janinë: 1978), fl. 92.

13 Alba Çela, "*Kush ishte "Osmani"?* Jeta e Ismail Qemal beut nga nëpunës i Perandorisë në veprimtar nationalist", në *Përpyekja*, Tiranë: vjeshtë 2008, nr. 25, f. 196.

14 Gazeta "Panorama", 28 nëntor 2009, Jetëshkrimi osman i Ismail Qemalit, përkthyer nga Dritan Egro.

15 Eqrem Vlora, *Kujtime (1885-1912)*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2001, f. 313.

Si pjesë e grupimit të deputetëve që përfaqësonin kombësitë jo turke në Perandori, I. Qemali ishte përndjekur nga autoritetet osmane. Për më tej, qëndrimi i tij pritës e jo bashkëpunues me ta, si dhe përfaqësimi i ideve mëvetësuese për shqiptarët në kornizën e Perandorisë Osmane, i acaronte akoma më shumë marrëdhëniet e tij me Stambollin¹⁶. Kjo kishte bërë që shqiptarët dhe të gjithë ata që ishin të pakënaqur me gjendjen ekzistuese në Perandori, të kishin shpresa tek I. Qemali, duke e bërë atë një ndër personalitetet më të përmendur në vend¹⁷. Për të dhe përkrahësit e tij, Shqipëria dhe Greqia duhej të bashkëpunonin veçanërisht në kushtet kur Perandoria Osmane po manifestonte çdo ditë e më shumë dobësi.

Në këtë kuadër, Ismail Qemali në vazhdimësi ishte parë me interes të veçantë nga rrethet e politikës greke, të cilët kishin konsiderata të larta për të. Në të vyejtën kohë, ai konsiderohej si politikan me shumë autoritet edhe midis deputetëve të nacionaliteteve të ndryshme në Parlamentin Osman, shumë prej të cilëve e pranonin atë si udhëheqësin e tyre¹⁸. Interesimin grek e përforconin mbështetja që Ismail Qemali i kishte dhënë zbatimit të nenit 23 të Traktatit të Berlinit¹⁹, qëndrimi që ai kishte mbajtur ndaj të drejtave të popullsisë greke të Kretës, dhe ndjenjat e tij pro greke, të cilat i gëzonte për hir të shkollimit në “Zosimea”, vlerësimit që kishte për kulturën e Greqisë Klasike²⁰.

Dallohej për kontaktet e tij me rrethet e politikës së Fuqive të Mëdha. Ai ishte liberal dhe pragmatist në politikë. Kishte bindjen se shpëtimi i shqiptarëve varej jo vetëm nga

16 *Po aty*, 246.

17 AIH, A.IV.322. Relacion i konsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vlorë, 26 shtator 1908.

18 *Po aty*, A-IV-405, fl. 17.

19 Gazmend Shpuza, *Në vazhden e gjurmimeve për epokën e Rilindjes Kombëtare (Përmbledhje shënimesh historike dhe historiografike)*, Tiranë: Toena, 1997, f. 115.

20 Ismail Qemali, *Kujtime*, Tiranë: Toena, 1996, f. 36.

përprjekjet e luftëtarëve të lirisë, por edhe nga zotësia për të shfrytëzuar diplomacinë. Nuk hezitonte të shprehte ndjenjat e tij antisllave. Mbështeste idenë se vetëm me një bashkëpunim shqiptaro-grek, lëvizja në vilajetin e Janinës do të mund të kishte rezultate dhe ekspansioni sllav në Ballkan mund të frenohej. Këto bindje kishin sjellë kontakte të herëpashershme midis tij dhe qeverive greke. Simpati për personalitetin e Ismail Qemalit kishte shprehur edhe mbreti i Greqisë, Gjergji I²¹. Midis tyre kishte pasur shtrëngime duarsh dhe shprehje reciproke ndjenjash miqësore si në Greqi, ashtu edhe në pritje të organizuara nga mbreti Eduard i Britanisë së Madhe.

I bindur se shqiptarët do ta vazhdonin luftën e tyre kundër Turqve të rinj sepse e ndjenin se rezistenca e tyre kombëtare ishte në rrezik²², Ismail Qemali kontaktoi me zyrtarët grekë. Në korrik të vitit 1910, ai kërkoi mirëkuptimin dhe ndihmën e Greqisë për botimin e librave për shkollat shqipe; mësimin e gjuhës shqipe në shkollat greke; krijimin e një komiteti greko-shqiptar me qendër në një qytet evropian, i cili duhet të merrte përsipër drejtimin e shqiptarëve për veprimtaritë e ardhshme. Komiteti duhej të krijonte degë në viset shqiptare, të cilat duhet të komunikonin mes tyre dhe sigurisht të kishin lidhje me komitetin greko-shqiptar, për të marrë të gjitha masat e nevojshme në mbrojtje të të drejtave shqiptare e greke kundër çdo armiku të përbashkët²³.

Kërkesat lidheshin kryesisht me aspektin kulturor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ato nuk preknin direkt vilajetin e Janinës dhe të Manastirit. Si të tilla ato morën mbështetjen e qeverisë greke madje dhe u tejkaluan duke u premtuar edhe armë në kuadrin e kryengritjes në Kosovë²⁴.

21 *Po aty*, f. 246, f. 340.

22 *HHSI, A.P.A. në AIH*, Vj. 20-15-1508, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Stamboll për ministrin e Jashtëm. Erental, Stamboll, 29 maj 1910.

23 V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 29.

24 *Po aty*

Qeveria greke e konsideroi si lokale kryengritjen në Kosovë. Për zyrtarët e saj kushtet për zgjidhjen e çështjes shqiptare nuk ishin pjekur ende dhe mungesa e solidaritetit jo vetëm mes shqiptarëve të Veriut dhe atyre të Jugut, por edhe mes vetë gegëve, ishte e dukshme.

Në përputhje me politikën e saj të jashtme, qeveria greke nuk ishte e gatshme të jepte asnjë lloj ndihme në Jug. Përfundimi me sukses i një kryengritjeje aty do t'i cilësonte provincat jugore përfundimisht si shqiptare. Për këtë arsye ajo iu përgjigj negativisht kërkesës së Ismail Qemalit për ta inkuadruar revoltën e Himarës me kryengritjen në Kosovë. Ministri i Jashtëm i Greqisë, udhëzoi konsullatat greke në vilajetet shqiptare, të përkrahnin vetëm luftën e malësorëve dhe të pengonin shtrirjen e kryengritjes në veri dhe në jug të Epirit²⁵. Inkuadrimi i dy lëvizjeve me njëra-tjetrën dhe përhapja e tyre edhe në vise të tjera në Vilajetin e Janinës do të shikohej keq prej saj. Popullsia e Himarës u këshillua të mos bashkëpunonte, por të dorëzonte protesta me shkrim pranë Fuqive të Mëdha.

25 *Po uty*, f. 31

The first of these is the fact that the United States is a young nation. It has only a few decades of history behind it, and its institutions are still in the process of being formed. This is in contrast to the European nations, which have a long and varied history, and whose institutions are well established and have had time to become firmly rooted in the minds of the people.

Secondly, the United States is a large and diverse nation. It covers a vast area of land, and its population is made up of many different races and nationalities. This diversity has led to a variety of customs and traditions, and has made it difficult to establish a single, unified system of government.

Thirdly, the United States is a nation of immigrants. The vast majority of its population are the descendants of people who came from other countries. This has led to a strong sense of national identity, but it has also led to a certain degree of social and economic inequality, as the immigrants and their descendants have often been treated as second-class citizens.

Finally, the United States is a nation of pioneers. It is a land of opportunity, and its people have a strong belief in the idea of the "American Dream". This has led to a spirit of adventure and exploration, and has made the United States a nation of frontiers.

These are the main reasons why the United States is a unique and interesting nation. It is a young, large, diverse, and pioneering nation, and its history is still in the process of being written. It is a nation of many contradictions, and it is a nation that is constantly changing and evolving.

It is a nation that has the potential to become a world leader, but it also has the potential to become a nation of social and economic inequality. It is a nation that is full of hope and possibility, but it is also a nation that is full of challenges and difficulties.

It is a nation that is a work in progress, and it is a nation that is still being shaped by its people. It is a nation that is full of life and energy, and it is a nation that is full of promise.

1875

1. The first of these is the fact that the United States is a young nation. It has only a few decades of history behind it, and its institutions are still in the process of being formed. This is in contrast to the European nations, which have a long and varied history, and whose institutions are well established and have had time to become firmly rooted in the minds of the people.

2. Secondly, the United States is a large and diverse nation. It covers a vast area of land, and its population is made up of many different races and nationalities. This diversity has led to a variety of customs and traditions, and has made it difficult to establish a single, unified system of government.

3. Thirdly, the United States is a nation of immigrants. The vast majority of its population are the descendants of people who came from other countries. This has led to a strong sense of national identity, but it has also led to a certain degree of social and economic inequality, as the immigrants and their descendants have often been treated as second-class citizens.

4. Finally, the United States is a nation of pioneers. It is a land of opportunity, and its people have a strong belief in the idea of the "American Dream". This has led to a spirit of adventure and exploration, and has made the United States a nation of frontiers.